REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1297 /18
Datë/Datum. 31.12.2018
PRISHTINË - PRIŠTINA

Rëpublika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIW BODY

DATË/A:	31.12.2018
PËR/ZA/TO:	**Operatorët Ekonomik** **Autoritetet Kontraktuese** **Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik**
NGA/OD/FROM:	**Blerim DINA,** Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim: lidhur me zbatimin e Platformës së E-prokurimit

Të nderuar,

Në bazë të nenit 102 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në mbështetje të vendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës, Nr. 12/79 të datës : 15.03.2016, Organi Shqyrtues i Prokurimit, lëshon këtë:

N J O F T I M

Me qëllim të funksionalizimit të plotë të platformës së prokurimit elektronik, dhe pasi që të gjitha aktivitetet e prokurimit në nivel të Republikës së Kosovës, prej datës : 01.01.2019 do të zhvillohen në mënyrë elektronike, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ju njofton se për të gjitha aktivitetet të cilat janë zhvilluar dhe do të zhvillohen në mënyrë elektronike edhe ankesat duhet detyrimisht të parashtrohen në mënyrë elektronike, përveç atyre rasteve kur aktivitetet janë zhvilluar edhe me kopje fizike, atëherë lejohet që ankesa të dorëzohet në kopje fizike.

Ky njoftim ndërlidhet edhe me njoftimin e dt: 26.12.2018 të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik mbetet i përkushtuar në respektimin e një procesi te drejtë dhe transparent gjatë shqyrtimit të të gjitha ankesave të Operatorëve Ekonomik.